



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZIVE**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10<sup>1</sup> të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-57 datë 14.02.2025 dhe Propozimin PA1 nr.08-57 datë 27.02.2025, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr. 02-799/8, datë 28.02.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, në seancën e 9-të mbajtur më 28.02.2025, ka miratuar:

**AKTVENDIM**  
**për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen**  
**e lejes për transmetim televiziv**

**NDALOHET** procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (shtr) T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJ, PA1 nr.08-55 datë 07.09.2023.

**A r s y e t i m**

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (Agjencia) në seancën e 7-të mbajtur më 18.02.2025, me Konkluzion nr.02-657, datë 18.02.2025, miratoi propozimin e dr. Zoran Trajçevski, Drejtor i Agjencisë, Pa1 nr.08-57 datë 14.02.2025 dhe ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJ, PA! Nr.08-55 datë 07.09.2023, për shkak se pas mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim arrk.nr.05-662/1 datë 14.02.2025, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (LSHMAAV), përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv Agjencisë.

Lidhur me këtë, nga Agjencia me datë 19.02.2025, drejtuar transmetuesit në fjalë është dërguar Shkresë PA! Nr.08-57 datë 19.02.2025, për njoftim se nëse nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë në aft prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miratojë vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv.

<sup>1</sup> Paragrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 248/18).



**Agjenci për shërbime  
mediatike audio dhe  
audiovizive**

**rr. Maqedonia nr 3 8  
1000 Shkup  
Republika e  
Maqedonisë së Veriut**

**tel. + 389 2 3103 400**

**[www.avmu.org.mk](http://www.avmu.org.mk)  
[www.avmu.mk](http://www.avmu.mk)  
[contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk)**





**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZIVE**

---

Megjithatë, më 26.02.2025, drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga Sektori për financa dhe logjistikë, është dorëzuar Njoftim ark.nr.05-662/2 datë 26.02.2025 se SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Struga SHPKNJP, më 25.02.2025, ka kryer pagesë në shumë prej 96.628,00 ( nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë) denarë, me çka kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv e ka paguar në tërësi.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10<sup>2</sup> të LSHMAAV, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-57 datë 14.02.2025 dhe Propozimin PA1 nr.08-57 datë 27.02.2025 në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-799/8 e datës 28.02.2025, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 9-të mbajtur më 28.02.2025, vendosi të ndalon procedurën e inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar nga sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike**  
**Audio dhe Audiovizuale**  
**Kryetari i Këshillit,**  
**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

---

<sup>2</sup> Paragrafët 8 dhe 9 fshihen , shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 248/18).